



Data: 07.11.2018 Ref.: 1560/180

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), bazuar në Aktgjykimin e Gjykatës Themelore të Prishtinës (nr. 1883/2014, datë 14 gusht 2018), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 60-të, të mbajtur më 26 tetor 2018, mori:

V E N D I M

- I. Refuzohet kërkesa e Kolegjit Universum nr.1465/01. Datë 22.07.2014 për rishqyrtim të vendimit të KSHC-së nr. 546/14 e datës 04.07.2014.
- II. Mbetet në fuqi vendimi i Këshillit Shtetëror të Cilësisë (KSHC) nr. 546/14, datë 04.07.2014.
- III. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetimi

I . BPrAL Kolegji "Universum" më datë 30.09.2013 ka paraqitur në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA) aplikacion për akreditim të programeve të studimit dhe për hapjen e degëve në Gjakovë dhe Prizren. Në përputhje me procedurat dhe standardet e akreditimit, aplikacioni i BPrAL Kolegji "Universum" është proceduar për aprovim në mbledhjen e Këshillin Shtetërorë të Cilësisë (KSHC) datë 14 janar 2014. Pas shqyrtimit të aplikacionit të BPrAL Kolegji "Universum", KSHC ka ardhur në përfundim që ky institucion nuk ka kapacitete te mjaftueshme për hapjen e dy degëve në të njëjtën kohë, dhe ka marr vendim që BPrAL Kolegji "Universum" ti nënshtrohet vlerësimit vetëm për një degë, duke mos përjashtuar asnjërën, por duke ja lënë BPrAL Kolegjit "Universum" të vendos se me cilën degë do të procedojë me tutje. (Vendimi i KSHC-së nr. 059/14, datë 27.01.2014.

Ky vendim u mor pasi që BPrAL Kolegji "Universum" kishte aktive dy degë, Kampusin kryesor në Prishtinë, dhe dega në Ferizaj, dhe pas vlerësimit të stafit akademik të deklaruar në AKA (nëntor 2013) nga Kolegji Universum, shihet qartë se nga dyzet e shtatë (47) persona të deklaruar si staf akademik, vetëm gjashtë (6) kishin gradën shkencore Dr.sc., në marrëdhënie të rregullt pune në këtë institucion, të cilët ishin: Bekim Podrimqaku; Rudina Degjoni; Ejup Fejza; Agon Demjaha; Jordan Daci; dhe Festina Balidemaj.

Sipas Udhëzimit Administrativ për Akreditim (02/2013, datë 16.01.2013), neni 11, pika 3.2: *"Të paktën 50% e stafit akademik duhet të jenë të punësuar me orar të plotë të përhershëm, duhet të jenë të kualifikuar në nivelin e PhD-së apo titujt e barasvlershëm artistik dhe duhet të jenë përgjegjës për të paktën 50% të orëve mësimore të një programi të studimit"*. Sipas këtij paragrafi, dhe bazuar në numrin e stafit të deklaruar nga ky institucion, Kolegji Universum do të duhej ti kishte të paktën 23 staf akademik me gradën shkencore Dr.sc., ndërsa sipas deklaratave, ky institucion kishte vetëm gjashtë (6) persona në marrëdhënie të rregullt të punës me gradën shkencore Dr.sc.

AKA ka organizuar procesin e akreditimit sipas Ligjit mbi Arsimin e Lartë (Nr. 04/L-037, datë 29 gusht 2011) dhe Udhëzimit Administrativ për Akreditim (nr.02/2013, datë 16.01.2013). BPrAL Kolegji Universum duke e parë që nuk ka mundur ti plotësoj kriteret për programet e studimit me të cilat kishte aplikuar, formalisht ka tërheq nga procedura e akreditimit programin e studimit Menaxhimi i Sistemeve të Informacionit, BA.

AKA ka vazhduar me procedurat e akreditimit dhe me 30 maj 2014 ka realizuar vizitën me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit (Stephen Adam; Andrew Goodspeed; dhe Petri Helo) në BPrAL Kolegjin Universum për vlerësimin e programeve të studimit me të cilat kishte aplikuar ky institucion më 30.09.2013: programet Gjuhë Angleze, BA dhe Qeverisje, MA.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të institucionit në fjalë dhe nga vizita e realizuar me 30 maj 2014 në BPrAL Kolegji Universum, ekspertët kanë hartuar raportin final (të dorëzuar në AKA me 13 qershor 2014) me të cilin kanë dhënë rekomandime shumë të qarta për mos akreditim të programeve të studimit Gjuhë Angleze, BA, dhe Qeverisje, MA.

Bazuar në nenin 22, pika 2 të Udhëzimit Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë (nr. 02/2013, datë 16.01.2013), Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) vendos duke u bazuar në rekomandimet e ekspertëve të dhënë në raportin vlerësimit. Pra ky vendim (vendimi nr. 546/14, datë 04.07.2014) është në përputhje të plotë me legjislacionin me të cilin AKA ka zhvilluar procesin e akreditimit.

- I. Sipas raportit final të ekspertëve për programin Gjuhë Angleze, BA, 180 ECTS, ekspertet përmendin këto probleme:

1. Programi ka probleme me strukturën e programit të studimit (faqe 10 dhe 11 e RF);
2. Personeli i paraparë për këtë program të studimit nuk ishte i mjaftueshëm, edhe pse ky institucion në vazhdimësi ka ndryshuar listën e stafit për programin në fjalë, siç janë: Raporti i Vetëvlerësimit i Kolegjit Universum, deklaratat e dhëna në AKA, vizita në terren, dokumentet e kërkuara pas vizitës, etj (faqe 7 e RF);
3. Mungesa e literaturës së nevojshme për këtë program të studimit. Këtu vëreheshin mos përputhje të dukshme në mes numrit të titujve të librave në RVV, dhe asaj që ekspertet hasen në numër dukshëm më të vogël të literaturës së domosdoshme, (faqe 7 e RF);
4. Një tjetër anomali e këtij programi sipas ekspertëve, është fakti se shumica e lëndëve të programit të studimit kanë nga 6 ECTS (faqe 8 e RF);
5. Sipas raportit të hartuar nga ekipi i ekspertëve, struktura aktuale e programit në tërësi minon zhvillimin e propozuar të aftësive, rritjen e kompleksitetit, ndërtimin e kompetencave më të mëdha, dhe ofrimi i strukturës adekuate kurrikulare për një student që të përparojë në një mënyrë të qartë dhe logjike. Programi ka ende difekte të thella, siç edhe u diskutua në takimin përmbledhës të realizuar gjatë vizitës së ekspertëve, dhe nga ekspertet u potencua që nuk mund të eksperimentohet me studentë.

Bazuar në atë çka u tha me sipër, KSHC në mbledhjen e mbajtur me 26 tetor 2018 vendosi ta refuzoj kërkesën e Kolegjit Universum, si të pabazuar dhe la në fuqi vendimin nr.564/14, datë 04.07.2014.

II. Sipas raportit final të ekspertëve për programin Qeverisje, MA, 120 ECTS, ekspertet ndërkombëtar të akreditimit kanë theksuar këto probleme:

1. Derisa programi i studimit pretendohet të ofrohet në gjuhën shqipe dhe në atë angleze, nuk ka dëshmi që stafi i angazhuar në këtë program të studimit ta ketë kompetencën për mbajtjen e ligjëratave në gjuhën angleze (faqe 14 e RF);
2. Vetëm një bartës i programit ka gradën shkencore PhD, ndërsa dy të tjerët janë PhD Cand., e që është jo e zakonshme që të ligjërohet në nivelin MA, personat që nuk kanë gradën shkencore Dr.sc. Kjo është në kundërshtim të plotë edhe me UA për Akreditim, neni 11, pika 3.2, sipas secilës: *"Për të siguruar lidhjen mes kërkimit shkencor dhe mësimdhënies në universitete ose kolegje universitare ky staf i përhershëm me orar të plotë duhet të përmbajë të paktën tre anëtarë për secilin program të studimit, prej të cilëve të paktën njëri duhet të jetë profesor i rregullt me orar të plotë që nuk është në moshën e pensionimit. Këto kërkesa kanë aplikim edhe tek kolegjet dhe institucionet tjera të arsimit të lartë të cilat nuk synojnë të kenë statusin e kolegjit universitar, përveç që nuk do të ketë kërkesa për ekipin e stafit të udhëhiqet nga një profesor i rregullt me orar të plotë edhe pse institucionit i lejohet të punësojë një person të tillë qoftë si person aktiv ose në moshën e pensionimit".*
3. Sipas RF të ekspertëve, vërehet mungesë e literaturës adekuate për këtë program të studimit. Biblioteka e Kolegjit Universum në Prishtinë përmban vetëm disa tekste të avansuara të përshtatshme. Lista e limituar e leximeve nuk përmban artikuj të journal-eve, të cilët janë me rëndësi për këtë nivel të studimeve (faqe 20 e RF);
4. Sipas ekspertëve, një tjetër shqetësim është fakti se: Nuk ekzistojnë politika specifike për zhvillimin e personelit të lidhura me këtë propozim (faqe 20 e RF), etj.

Bazuar në atë çka u tha me sipër, KSHC në mbledhjen e mbajtur me 26 tetor 2018 vendosi ta refuzoj kërkesën e Kolegjit Universum, si te pabazuar dhe la ne fuqi vendimin nr.564/14, datë 04.07.2014.

III. Për hapjen e degës në Gjakovë, ekspertet në menyrë të çartë kanë dhënë rekomandimet e tyre në faqen 24 të Raportit Final. Sipas këtij rekomandimi, Kolegji Universum plotëson kushtet minimale vetëm për programin e studimit, Biznes dhe Menaxhment, BA, ndërsa refuzohet kërkesa për programin e studimit Administratë Publike, Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Studime Evropiane, BA, 180 ECTS.

Refuzimi për programin e studimit Administratë Publike, Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Studime Evropiane, BA, 180 ECTS, sipas ekspertëve është rezultat e mungesës se stafit akademik për implementimin e këtij programi, pasi që nga deklarimi i stafit akademik nga dyzet e shtatë (47) persona të deklaruar si staf akademik, vetëm gjashtë (6) kishin gradën shkencore Dr.sc. Derisa Kolegji Universum, ushtron veprimtarin e vet në Kampusin ne Prishtinë, degën në Ferizaj, dhe tani degën në Gjakovë, është e pamundur zgjerimi i numrit te programeve me vetëm gjashtë persona në marrëdhënie te rregullt me gradën shkencore Dr.sc.

Bazuar në atë çka u tha me sipër, KSHC në mbledhjen e mbajtur me 26 tetor 2018 vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqitet ankesë sipas nenit 125 dhe 126, të Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative (tash e tutje LPPA) nr. 05/L-31, datë 25 maj 2016. Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit i cili e ka nxjerr këtë vendim bazuar në nenit 128 të LPPA, në afatin prej 30 nga dita kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas nenit 127 të LPPA.

Vendimi iu dërgohet:

- BPrAL Kolegji Universum;
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.


Prof. Dr. Gazmend Luboteni
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë

